- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFJEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, **një certifikatë e pranimit të përkohshëm.**

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë te punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës se defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës se defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë pune, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranim të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimi përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të parealizuar në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërprente punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 **"Force Madhore"** siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES**KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]


Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	Emri i Autoritetit Kontraktues: Komuna e Rahovecit me adresë në rrugën "Xhelal Hajda – Toni" të cilën e përfaqëson Menaxheri i Prokurimit: Jetulla Kabashi dhe Emri i Kontraktuesit: N.P.N. "EUROING" me adresë në Rahovec, të cilën e përfaqëson Kujtim Thaqi janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë: TITULLI I KONTRATËS: RIPARIMI I SHTËPISË SË KULTURËS NË RATKOC Numri i Prokurimit: 623-18-6752-5-2-1 Numri i Brendshëm: 623-18-053-5-2-1
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: Gjuha Shqipe.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	7.2	10% i ndalet një vit pas pranimit teknik të punimeve. Pagesa e shumës së ndalur ne emer te sigurimit te punimeve (10%) mund të i paguhet: Operatorit Ekonomik me : a. Vendim të Kryetarit të Komunës për leshimin e pageses së 10% te ndalur ne emer te sigurimit te punimeve dhe b. Nese OE e sjell garancionin nga ndonje kompani e licencuar e sigurimeve ose nga ndonje bankë (për periudhen për të cilën edhe është ndalur 10%). Pagesat kontraktuesit do t'i bëhet në bazë të raportit të organit mbikqyrës.
Programi	8.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda [5] ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	8.2	Periudha për Programin e azhurnuar është [5] ditë
Inspektimi dhe testimi	9.1	Organi Mbykqyrës është: Inspektimi dhe testimi behet konform kushteve te përgjithshme te kontratës.
Fillimi i punëve	10.1	Punët do të fillojnë brenda Pesë [5] dite pune pas ftesës nga autoriteti kontraktues përkatësisht nga ana e organit mbikëqyrës ose menaxheri i projektit. Ftesa për fillim të punëve do të behet me krijimin e kushteve atmosferike.
	10.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: Sipas Dinamikës së punëve dhe arsyeshmeris së vonesave të lejuara nga organi mbykqyrës. Kontrata është: 24 muaj.

Përmirësimi i defekteve	13.1	Periodha garantuese e defekteve është: 12 muaj.
Shkaqet për kompensim	17.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë: Sipas Kushteve të përgjithshme të kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: Nëse Kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë/realizoj ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, punëdhënësi, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me [0,05%] në ditë, të vlerës së punëve të pa dorëzuara/realizuar deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës.
Parapagimi	20.1	Shuma e Parapagimit është: nuk aplikohet.
Mbajtja e Parasë	21.1	Shuma e parave të mbajtura është: <i>[shëno përqindjen]</i>
Siguria e ekzekutimit	22.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10% të vlerës së kontratës = 11,595.78 €, për kohëzgjatjen e periudhës prej: [24 muaj + 30 ditë].
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	27.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve. Pagesa do të behet vetëm për punët e përfunduara sipas raportit të organit mbikëqyrës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	31.2	Autoriteti kontraktues cakton departamentin e Komisionit përgjegjës për pajtim.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Gjakovë – Dega Rahovec] në pajtim me ligjin në Kosovë.

Paramasa dhe Paralogaria					
RENOVIMI I SHTËPISË SË KULTURËS					
P + 1					
Ratkoc, K.K. Rahovec					
1. ARKITEKTURA					
1.1. PUNËT PËRGADITORE					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.1.1	Punimi dhe montimi i tabelës informuese 1.5 x 2.0 m nga profilet metalike dhe llamarina, paraprakisht të aprovohet nga organi mbikëqyrës, apo investitori.	paushall	1.00	100.00 €	100.00
1.1.2	Furnizimi , transporti dhe vendosja e kontinierëve, kabinës së WC-së për punëtorë dhe të njëjtat largohen pas përfundimit të punimeve.	paushall	1.00	10.00 €	10.00
1.1.3	Furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkohëshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndriqimit të kantierit.	paushall	1.00	10.00 €	10.00
1.1.4	Furnizimi me material dhe punimi i rrethojës së kantierit kah ana e rrugës. Rrethoja duhet punuar me material të qëndrueshëm të paktën llamarinë se zingtuar me lartësi 2 m. Pas përfundimit të punimeve të largohet nga vendpunishtja. Vërejtje: Të krijohet edhe hapësira për kalim të banorëve	m'	90.00	2.00 €	180.00
1.1.5	Dritaret, dyert të mbulohen gjate ngjyrosjes si dhe punëve te tjera, me folie PVC te trashe per shkak të mbrojtjes dhe pas përfundimit të punëve, me kujdes të pastrohen mekanikisht të gjitha sipërfaqet dhe të lahen me ujë duke u shtuar agjentet e duhur kimik. Për çdo dëmtim eventuaal barra e pagesës i bie punëkryesit.	paushall	1.00	100.00 €	100.00
1.1.6	Pas përfundimit të plotë të renovimit të objektit të bëhet pastrimi detaj i objektit brenda dhe jashtë. Mbeturinat, materiali të transportohet në deponi të caktuar nga investitori.	paushall	1.00	100.00 €	100.00
TOTALI POSICIONI:					500.00




1.2. PUNËT E DEMOLIMIT					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.2.1	Largimi i inventarit të brendshëm - karrikave, tavolinave të punës etj. Në çmim të parashihet transporti i tyre në vendin e caktuar nga investitori.	paushall	1.00	100.00 €	100.00
1.2.2	Çmontimi i ulëseve metalike të spektatorëve, të cilat janë të përforcuara për shkallarë dhe të largohen në vendin e caktuar nga investitori, apo organi mbikëqyrës. Të njëjtat përsëri vendosen pas përfundimit të punimeve Vërejtje: Çmontimi i i ulëseve të bëhet me kujdes të shtuar, pa i dëmtuar	copë	205.00	1.00 €	205.00
1.2.3	Demolimi i dritares së dëmtuar (komplet) në katin e parë, siç është paraqitur në pjesën grafike. Në çmim të përfshihet edhe demolimi i parapetit të dritares. Dritarja e demoluar të largohet në deponi të caktuar nga investitori.	copë	1.00	10.00 €	10.00
1.2.4	Largimi i qelqit të thyer (dëmtuar) nga profilet e PVC-së të dritareve dykrahëshe me dimensione 160 x 160 cm. Qelqi i thyer të largohet në deponi të caktuar nga investitori.	copë	5.00	2.00 €	10.00
1.2.5	Largimi i qelqit të thyer (dëmtuar) nga profilet e PVC-së të derës dykrahëshe me dimensione 160 x 310 cm. Qelqi i thyer të largohet në deponi të caktuar nga investitori.	copë	1.00	2.00 €	2.00
1.2.6	Çmontimi dhe largimi i mekanizmave të dëmtuar të dritareve deri në deponi të caktuar nga investitori.	paushall	1.00	10.00 €	10.00
1.2.7	Çmontimi - heqja nga bagllamat e të gjitha dyerve, të mbështjellen me folie PVC dhe të vendosen në deponi të përkohëshme. Të gjitha dyert të shënohen - emërtohen gjatë largimit. Të rivendosen prapë në vendet përkatëse (mëparëshme) dhe pas përfundimit të punëve, me kujdes të pastrohen mekanikisht të gjitha sipërfaqet dhe të lahen me ujë duke u shtuar agjentet e duhur kimik. Për çdo dëmtim eventuaal barra e pagesës i bie punëkryesit.	paushall	1.00	50.00 €	50.00
1.2.8	Demolimi i tepisonit në dysheme në përdhese dhe kat. Tepisoni i demoluar të largohet në deponi të caktuar nga investitori.	m ²	445.00	0.20 €	89.00
1.2.9	Demolimi i binës (podiumit) dhe shkallarëve. Materiali demolues të largohet në deponi të caktuar nga investitori, apo organi mbikëqyrës.	paushall	1.00	50.00 €	50.00
1.2.10	Demolimi i dyshemesë nga laminati. Materiali i demoluar të largohet në deponi të caktuar nga investitori.	m ²	286.00	0.20 €	57.20



1.2.11	Demolimi i pllakave të qeramikës në dysheme në përdheshë dhe në mure te toaletet. Materiali i demoluar të largohet në deponi të caktuar nga investitori.	m ²	198.00	2.00 €	396.00
1.2.12	Demolimi i tërësishëm i shtresës nivelizuese së bashku me termolizolim deri në pllakën konstruktive (themel-pllakë, konstrukcioni meskatësh). Materiali i demoluar të largohet në deponi të caktuar nga investitori.	m ²	464.00	2.00 €	928.00
1.2.13	Gërryerja e suvasë dhe ngjyrës në mure dhe pllafon. Materiali i demoluar të largohet në deponi të caktuar nga investitori. Në çmim të parashihet edhe kujdesi i shëndetit të puntorëve, vendosja e maskave gjatë gërryerjes e domosdoshme për shkak të mykut.	m ²	2,320.00	1.00 €	2,320.00
1.2.14	Demolimi i pllakave amstrong të pllafonit të lëshur. Materiali i demoluar të largohet në deponi të caktuar nga investitori. Vërejtje: Profilet mbajtëse metalike të mos dëmtohen	m ²	184.00	0.50 €	92.00
1.2.15	Demolimi i murit me dimensione 200 x 210 cm, për vendosjen e derës me dimensione 180 x 210 cm. Në çmim të parashihet edhe punimi i arkitraut.	m ²	6.00	10.00 €	60.00
1.2.16	Demolimi i shkallëve lëvizëse që shërbejnë për dalje në kulm. Materiali i demoluar të largohet në deponi të caktuar nga investitori.	paushall	1.00	5.00 €	5.00
1.2.17	Demolimi i tërësishëm i parterit nga betoni si dhe largimi i shtresës së zhavorit përreth objektit. Materiali i demoluar të largohet në deponi të caktuar nga investitori.	m ²	70.00	1.00 €	70.00
1.2.18	Demolimi, largimi, gërryerja e të gjitha shtresave të cokllës së improvizuar deri në blloqe. Materiali i demoluar të largohet në deponi të caktuar nga investitori.	m ²	54.00	2.00 €	108.00
1.2.19	Demolimi i tërësishëm i kulmit nga llamarina e plastifikuar së bashku me konstrukcion të kulmit dhe shtresat përcjellëse. Materiali i demoluar të largohet në deponi të caktuar nga investitori.	m ²	465.00	1.00 €	465.00
1.2.20	Demolimi i shtresës rrafshuese të nivelizimit në pllakën e kulmit së bashku me termoizolim deri në pllakën konstruktive. Materiali i demoluar të largohet në deponi të caktuar nga investitori. Në çmim të parashihet edhe pastrimi i detajizuar i dyshemesë pas demolimit.	m ²	478.00	2.00 €	956.00
1.2.21	Demolimi i ulluqëve horizontal. Materiali i demoluar të largohet në deponi të caktuar nga investitori. Në çmim të parashihet edhe demolimi i llamarinës mbi muret e atikës.	m'	92.00	0.50 €	46.00



1.2.22	Demolimi i ulluqëve vertikal me të gjitha elementet përcjellëse me kujdes të mos ketë dëmtime në fasadë. Materiali i demoluar të largohet në deponi të caktuar nga investitori.	m'	35.00	0.50 €	17.50
1.2.23	Demolimi me kujdes të shtuar të trupave ndriques. Në çmim të llogaritet edhe transporti deri në deponi të caktuar nga investitori.	paushall	1.00	50.00 €	50.00
1.2.24	Demolimi me kujdes të shtuar të prizave dhe ndërprerësive. Në çmim të llogaritet rivendosja e tyre në pozitën e mëparëshme. Vërejtje: Prizat dhe ndërprerësat e dëmtuar të largohen në deponi të caktuar nga investitori.	paushall	1.00	50.00 €	50.00
1.2.25	Çmontimi i radiatorëve me kujdes të shtuar me të gjitha elementet përcjellëse. Radiatorët të dërgohen në vend të caktuar nga investitori. Të njëjtit të rivendosen në vendin përkatës, pas përfundimit të punimeve. Vërejtje: Radiatorët të mos dëmtohen. Në rast dëmtimi përgjegjësinë e bart punëkryesi (kontraktuesi).	copë	31.00	3.00 €	93.00
1.2.26	Demolimi me kujdes i gypave të ngrohjes. Gypat të dërgohen në vendin e caktuar nga investitori. Të njëjtit të rivendosen në vendin përkatës, pas përfundimit të punimeve.	paushall	1.00	50.00 €	50.00
1.2.27	Demolimi me kujdes të shtuar i kalladajës, bojlerit dhe të gjitha elementeve përcjellëse në kthinën e kalladatores dhe të dërgohen në vendin e caktuar nga investitori. Të njëjtat të rivendosen përsëri në vendin përkatës.	paushall	1.00	100.00 €	100.00
1.2.28	Demolimi i lavamanëve, me të gjitha elementët përcjellëse. Të njëjtat transportohen në deponi të caktuar nga investitori.	copë	2.00	5.00 €	10.00
1.2.29	Demolimi i WC Guacave, me të gjitha elementët përcjellëse. Të njëjtat transportohen në deponi të caktuar nga investitori.	copë	4.00	5.00 €	20.00
1.2.30	Demolimi i kolektorit dhe të gjitha gypave me të gjitha pjesët përcjellëse të instalimit të ujësjellësit. Të njëjtat transportohen në deponi të caktuar nga investitori.	paushall	1.00	50.00 €	50.00
1.2.31	Demolimi i të gjitha gypave me të gjitha pjesët përcjellëse të instalimit të kanalizimit dhe pusetave rreth objektit. Të njëjtat transportohen në deponi të caktuar nga investitori.	paushall	1.00	50.00 €	50.00
1.2.32	Demolimi i të gjitha gypave të drenazhës dhe pusetave rreth objektit. Të njëjtat transportohen në deponi të caktuar nga investitori.	paushall	1.00	50.00 €	50.00
TOTALI POSICIONI:					6,569.70



1.3. PUNËT E GËRMIMIT

	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.3.1	Gërmimi dheut përreth objektit në gjerësi 80 cm dhe thellësi 20 cm nën pllakë themel të objektit, për shtrirjen e gypave të drenazhës. Gërmimi kryhet parciaisht dhe me kujdes të shtuar, përshkak mos rezikimit të stabilitetit të objektit.	m ³	90.00	1.50 €	135.00
1.3.2	Gërmimi i tokës në thellësi deri 60 cm dhe gjerësi 40 cm për hapjen e themeleve shiritore të murit rrethues të objektit	m ³	40.00	1.50 €	60.00
TOTALI POSICIONI:					195.00

1.4. PUNËT E HIDROIZOLIMIT

	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.4.1	Furnizimi me material dhe punimi i hidroizolimit të balloreve të themelit dhe mureve në lartësi h= 70 cm, me hidroizolim të ftoftë me lyerje bitumeni, pas gërryerjes të mureve gjerë në bllokë, dhe shërben si shtresë për shpërndarjen e ujit. Para ngjitjes së shiritit izolues të pastrohet pluhuri dhe të përmissohet baza, që izolimi të bëhet sa më i mirë. Ndërsa, shtresa tjetër do izolohet me hidroizolim të ngrohtë me kondor të dyfishtë. Në çmim të parashihet edhe styroduri me t= 3 cm për mbrojtjen e hidroizolimit.	m ²	97.00	10.00 €	970.00
1.4.2	Furnizimi me material dhe shtruarja e geotekstilit HaTe m300, në pjesën e poshtme të gropës së gërmuar për vendosjen e gypave të drenazhës dhe të mbështetet për themele dhe gjerë të muret periferike të objektit. Paraprakisht të bëhet pastrimi i i themelit dhe mureve.	m ²	220.00	2.00 €	440.00
1.4.3	Furnizimi me material dhe vendosja e hidroizolimit në dysHEME, në të gjitha kthinat, si dhe në mure periferike të kthinave gjerë 50 cm lartësi nga dysHEMEJA me hidroizolim të ftoftë me Sika Lastic 1 K, dhe shërben si shtresë për shpërndarjen e ujit. Është e prodhuesit Masterbit Primer WBP, ose të ngjajshme. Është i përshtatshëm para ngjitjes së shiritit izolues për ta pastruar pluhurin dhe përmirësuar bazën që izolimi të bëhet sa më i mirë. Ndërsa, shtresa tjetër do izolohet me hidroizolim të ngrohtë me kondor të dyfishtë 04 GV 4mm të prodhuesit Masterbit, ose të ngjajshme, me peshë 4600g/m ² . Materiali dhe shtresa bartëse e tij është fije qelqore, me tip bitumeni të oksiduar, me rezistencë nga uji min. 10 kPa. Ky material mund të zëvendësohet nga një material me karakteristika të ngjajshme.	m ²	785.00	10.00 €	7,850.00



1.4.4	Furnizimi me material dhe punimi i hidroizolimit të ftohtë mbi pllakën e dyshemesë të toaletet me këto shtresa: lyerja me EKOPRIMER A; PRIMOFLEX NT me atest (-15 +100)°C, ISO 9002; (ose prodhues tjetër me kualitet dhe karakteristika të njëjta). Në tërë masën e betonit i cili përdoret për formimin e pllakës së dyshemesë duhet të shtohet aditiv i lëngët "Sikacrete P" në masën e betonit. Si dhe ngritja e hidroizolimit në mure min. 100cm.	m ²	32.00	5.00 €	160.00
1.4.5	Furnizimi me material dhe punimi i hidroizolimit me Sikamur Injection te mureve perimetrike dhe ne ato mure ndarese ku kemi lageshti . Lartesia e injektimit ne mure duhet te jete deri ne lartesi h=50 cm , ku injektimi ne pare duhet te jete ne lartesi 15 cm , ndersa injektimi i dyte ne lartesi 30cm . Ne cmime te parashihet i gjithe materiali i nevojshem per ekzekutim	m ²	295.00	5.00 €	1,475.00

TOTALI POSICIONI: 10,895.00

1.5. PUNËT E NIVELIZIMIT

	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.5.1	Furnizimi dhe punimi i nivelizimit të dyshemeve, që do bëhet me stiropor 3 cm të prodhuesit Isomaster EPS 70 ose EPS-L 70 me rezistencë në shtypje 70kPa dhe përçueshmeri të nxehtësisë (λ) 0.041 W/mK, me rezistencë paradifuzive (μ) 20-40. Kurse rrethperimetrit të mureve do vëndosim stiropor 2 cm. Ndërsa shtresa rrafshuese nivelizuese (estrih) 5-7 cm sipas nevojës dhe kushteve të pllakave konstruktive në përdhese, në kat - holli qendror. Në çmim të logaritët edhe rrjeta armaturë.	m ²	492.00	9.00 €	4,428.00
1.5.2	Furnizimi dhe punimi i nivelizimit të dyshemeve të nyjeve sanitare, që do bëhet me stiropor 2 cm të prodhuesit Isomaster EPS 70 ose EPS-L 70 me rezistencë në shtypje 70kPa dhe përçueshmeri të nxehtësisë (λ) 0.041 W/mK, me rezistencë paradifuzive (μ) 20-40. Kurse rrethperimetrit të mureve do vëndosim stiropor 2 cm. Ndërsa shtresa për ramje ne hapsirat e sanitareve dhe hapsirave higjienike me ARDURAPID 35	m ²	32.00	8.00 €	256.00
TOTALI POSICIONI :					4,684.00




1.6. PUNËT E DYSHEMESË					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.6.1	Furnizimi me material dhe vendosja e pllakave QERAMIKE në dysheme me dim. 30x30x0.8 cm. në nyje sanitare, të kualitetit të parë të palëmuara, rezistente në rreshqitje joabsorbuese, rezistente ndaj abrazionit, kemikaleve. Në çmim parashihen edhe ngjitësi i pllakave ARDUTIT X7G. Ngjyra të përcaktohet nga investitori.	m ²	25.00	16.00 €	400.00
1.6.2	Furnizimi me material dhe vendosja e pllakave QERAMIKE në dysheme me dim. 30x30x0.8 cm. te foajeu, holli i sanitareve dhe në kthinën e kalldatores, të kualitetit të parë të palëmuara, rezistente në rreshqitje joabsorbuese, rezistente ndaj abrazionit, kemikaleve. Në çmim parashihen edhe ngjitësi i pllakave ARDUTIT X7G. Ngjyra të përcaktohet nga investitori.	m ²	83.00	16.00 €	1,328.00
1.6.3	Furnizimi me material dhe vendosja e dyshemesë nga laminati duke u bazuar në instrukcionet e prodhuesit në kthinat të paraqitura në pjesën grafike ku në çmim të parashihen edhe këndoret me lartësi 10 cm, si dhe këndoret nga alumini në pjesët ku kemi ndryshim të dyshemesë. Ngjyra, tekstura dhe dimensionet të përcaktohen nga investitori.	m ²	240.00	12.00 €	2,880.00
1.6.4	Furnizimi me material dhe vendosja e dyshemesë nga tepisoni PA kundra zjariti kualitetit të lartë në sallë dhe hollin e sipërm. Në çmim të parashihen këndoret nga druri ne lartësi 10 cm dhe ngjitësi i tepisonit. Ngjyra, tekstura dhe dimensionet të përcaktohen nga investitori.	m ²	479.00	15.00 €	7,185.00
TOTALI POSICIONI :					11,793.00
1.7. PUNËT E SUVATIMIT, NGJYROSJES DHE QERAMIKAVE NË MURE					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.7.1	Furnizimi me material dhe suvatimi i mureve dhe pllafoneve me POFIX (në thas) ose ekuivalent. Suvatimi të bëhet deri në rrafshim të plotë. Në çmim të parashihen edhe këndoret metalike të parapara për suvatim.	m ²	2,320.00	5.00 €	11,600.00
1.7.2	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve dhe plafoneve me ngjyrë dy komponentale (duke përfshirë edhe lyerjen paraprake me "Primer" adekuat) të karakteristikave si vijon: -Rezistenca ndaj gërryerjes 3 Norma EN 13300	m ²	2,320.00	1.00 €	2,320.00



1.7.3	Furnizimi me material dhe vendosja e pllakave të qeramiks për mure në nyje sanitare, me dim. 30x20x 0.8 cm të klasit të parë me ngjithës të pllakave (ARDURID X7G) ose ekuivalent. Ngjyra të përcaktohet nga investitori, ose organi mbikëqyrës.	m ²	105.00	16.00 €	1,680.00
TOTALI POSICIONI:					15,600.00

1.8. PUNËT E KULMIT


	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.8.1	Furnizimi me material dhe aplikimi i termoizolimit në trashësi sipas detalit t=15 cm (3x50 nga PIR (Poliuretani), XPS ose leshi i gurit i vendosur lirshëm mbi pendën kundër avullit në përgjithësi sipas detajit. Pllakat e termoizolimit duhen të vendosen me kujdes dhe lidhjet ndërmjet pllakave duhen të jenë pa devijime dhe pa thyerje (dëmtim) teheve. Dëmtimet eventuale duhen te sanohen. Shtresa termoizoluese duhet të i plotësoj këto kushte dhe karakteristika teknike: - Densiteti rreth > 30 kg/m ³ - Rrezistenca në shtypje > 150 kPa, EN 826 - Përformanca kundër zjarrit Euroclass RtF E, EN 13501-1 - Koeficienti i përçueshmërisë $\lambda = 0.022 \text{ W/(m/K)}$ EN 12667 / EN 12939	m ²	498.00	17.00 €	8,466.00
1.8.2	Furnizimi me material dhe Aplikimi i shtresës ndarëse ndërmjet termoizolimit dhe hidroizolimit me gjeotekstil 500 gr/m ² .	m ²	498.00	3.00 €	1,494.00
